

NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Nobelisti që linte oret e mësimit dhe trillonte gënjeshtër

Harold Pinter, të pathënat

Dossier nga Endrit Shtylla

faqe 16-17




Përsiatje rreth librit poetik "Frika nga Atdheu" botim i "Nacional" 2009

Ka thënë guri...

Nga Hamit Aliaj

faqe 20-21



EDITORIAL

Presidenti Rugova

Nga Skënder Buçpapaj

Ibrahim Rugova ka një vepër të bollshme dhe më cilësorën e llojit në letrat shqipe. Por ai është një krijues i ndërprerë. Sepse, kur u nda nga vepra letrare për t'i hyrë aktivisht politikës, ai ishte në kulmin e krijimtarisë së tij. Ibrahim Rugova ka një jetë të pasur me arritje në të gjitha fushat kryesore ku pati rolin e tij.

Vijon në faqen 3

Kosova 2010

Nga Gani Tërshnjaku

Për të bërë një vlerësim mbi situatën e ardhshme, për aksionet dhe zhvillimet kryesore që pritet të ndodhin në gjashtëmujorin e parë 2010 në Kosovë, duhet analizuar një sërë faktesh dhe situatën në të cilën po kalon vendi...

Vijon në faqen 28-29

Gazeta "Nacional" dhe Radio

"Nacional" urojnë të gjithë shqiptaret:

"Gëzuar Vitin e Ri 2010!"



Editoriali që ka 112 vjet që vazhdon të bëjë histori

Po, Virxhinja, babagjyshi i Vitit të Ri ekziston

Nga Elida Buçpapaj

faqe 33



Në BRENDËSI

Heshtja

Poezi nga Pablo Neruda

faqe 9

Darka e Kadaresë

Studim nga Mexhit Prençi

faqe 12-13

Katër herë jo

Tregim nga Bashkim Hoxha

faqe 7

Poezia e Bajazit Cahanit

Studim nga Besim Cengu

faqe 24-25

Me Emili Dikenson

Kritikë nga Gjekë Marinaj

faqe 4

Poezi nga: Sazan Goliku, Valbona Hykaj, Agim Desku, Naim Kelmendi, Vehbi Miftari, Ivana Dervishi, Novruz Shehu

faqe 11-26

Poezia e Bardhyl Londos

Kritikë nga Agim Vinca

faqe 22

Tregime nga: Zhuljana Jorganxhi, Vilhelme Vranari (Haxhiraj)

faqe 14-23

Esse nga Paul Skot, Nazmi Lukaj, Isuf Meshi, Enver Memishaj, Xhahid Bushati

faqe 19-33

ARMO Albanian Refining & Marketing of Oil

**PËR HERË TË PARË
EURODIESEL
I STANDARTEVE EUROPIANE**

PCALBANIA
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art

Koha e hezitimeve në letërsinë Amerikane

Poetët nuk vdesin — ata vetëm kalojnë në orën e njëzetepestë të ditës



Në foto: Gjekë Marinaj

Ndoshta shpjegimi më i përafërt me të vërtetën e mbijetesës së poetes Emily Dickinson, njëra nga poetet më të fuqshme në historinë e deritanishme të letërsisë botërore, është dashuria e jashtëzakonshme për poezinë, në njërën anë, dhe besimi që dashuria e saj do të jetojë më gjatë me poezinë se frymëmarrja e saj si poete

Nga Gjekë Marinaj

Shpesh tek poetët frymëzimi vjen si një stuhi e çuditshme, fuqia lëvizëse e së cilës çliron nga gjoksi i tyre poetik emocionet për t'i komunikuar. Dueli shpirtëror midis poetit, si njeri, dhe muzës, si burim i frymëzimit poetik të tij, shndërrohen në atë gjini letrare që ne e quajmë poezi. Ndonëse teknikisht poezia mund të paraqitet më e organizuar sikur të kalojë nëpërmjet redaktorëve profesionalë, jeta e saj fillon pa kushte në çastin kur shkëputet nga shpirti i poetit. Poezia pastaj shtegton drejt përjetësisë së saj herë e lënduar, herë e vetmuar, herë e dënuar dhe, më së shumti, e lirë. Por, në kushte normale, poezia kurrë nuk vdes. Të njëjtin fat kanë edhe poetët. As poetët nuk vdesin kurrë - ata, kur mbyllin sytë, vetëm kalojnë në orën e njëzetepestë të ditës. Ndryshe nuk ka se si të kuptohet jeta dhe vepra e poetes amerikane të shekullit XIX, Emily Dickinson.

Të ndjesh dhe të kuptosh jetën në ngjyrat e plota të saj është një gjë, por të jetosh ashtu siç e ndjen dhe e kupton atë është një gjë krejt tjetër. Ndjekja e dallgëve të ndjenjave, për secilin nga ne, është një trazirë psikologjike që kërkon arsytim të veçantë. Për poetët, nga ana tjetër, parimi i arsytimit është disa herë më esencial. Kjo jo vetëm për faktin se poezia, si produkt shpirtëror i poetit, është thjeshtë thënia me art e së vërtetës, por edhe se e vërteta në vetvete ka një substancë, efektet e së cilës reagojnë në përpjestim të zhdrejtë me interesat individuale të disa "personave".

Ndoshta shpjegimi më i përafërt me të vërtetën e mbijetesës së poetes Emily Dickinson, njëra nga poetet më të fuqshme në historinë e deritanishme të letërsisë botërore, është dashuria e jashtëzakonshme për poezinë, në njërën anë, dhe besimi që dashuria e saj do të jetojë më gjatë me poezinë se frymëmarrja e saj si poete. Ajo konsideronte punën me poezinë të natyrshme, ashtu siç quajnë nënat e motrat tona të natyrshme dashurinë për fëmijët. Duke e parë rolin e saj si poete në këtë prespektivë, ajo padashur krijoi një barrierë modestie për punën e saj me vargjet.

Dickinson, në gjithë jetën e saj, u takua vetëm një herë me poetin Walt Whitman. Nga që nuk dinin asgjë për njëri-tjetrin, e gjithë biseda midis tyre filloi dhe mbaroi me këto fjalë:

"Mirëdita! Unë jam askush! Po ju kush jeni?" -Walt, u përgjigj tjetri.

Për poetët si Emily Dickinson, Sidney Lanier, William Vaughn Moody, që jetuan "kohën e hezitimeve" në letërsinë Amerikane, modestia në momente të caktuara mund të ishte veprim inteligjent, sepse anasjelltas mund të nxiste kuriozitetin e të tjerëve ndaj tyre dhe po kështu, të afronte levërdinë e të jetuarit pa presionin e njeriut të famshëm. Në kontrast, ama, në rastin e mësipërm, modestia e la Emily Dickinson-in pa mbështetjen profesionale të njërit prej poetëve më të mëdhenj të botës, për udhëzimet e kualifikuara të të cilit ajo kishte shumë nevojë. Pavarësisht se ajo nuk e dinte se po fliste me një poet kaq të madh, siç ishte Whitman-i, dhe



ndonëse dedikimi i të dyre ndaj poezisë ishte absolut dhe i pakomprometueshëm, ajo kurrë nuk e paraqiti veten para tij si poete. Ajo, mund të themi, s'kishte si të bënte ndryshe. Deri në atë kohë, kishte botuar gjithësej vetëm shtatë poezi. Pra, po të përqendrohemi në numrin e poezive që ajo kishte botuar, natyrisht me prezantimin e saj si poeteshë para Whitman-it mund të rrezikonte përcëlimin apo të paktën nënvlerësimin e tij ndaj saj. Gjithçka mund të ndodhin... Po, gjithçka mund të kishte ndodhur... Por nuk duhet të harrojmë dashurinë që poetët kanë për njëri-tjetrin. Unë mendoj se do të kishte ndodhur e kundërta. Me siguri do të kishte ndodhur e kundërta. Oh, sikur t'i kishte thënë se kush ishte! E pasi të ishin njohur, sikur ajo të kishte nxjerrë nga gjiri nja njëqind apo dyqind vjersha dhe t'ia kishte zgjatur për t'i parë! Vetëm mendo bashkimin e dy qiejve aq të mëdhenj poetik... Kushedi se ç'ngarkesë "elektrike" do të kishte përshkuar shekullin e XIX-të prej bashkimit të tyre. Imagjoni nivelin e frymëzimit, magjinë artistike, përqaftimin e pasionit letrar që do të kishin ndjerë nga bashkimi të dy poetët — dy epiqendrat e tërmetit poetik të atij shekulli, që gjithmonë vibërojnë diçka të çuditshme brenda vetes, kur flasim për ta.

Në jetën e një artisti është e nevojshme prezenca e një artisti tjetër. Kjo i frymëzon artistët, i shtynë ndrejt niveleve më të larta krijuese, ua rrit guximin për t'u paraqitur para artëdashësve... Ne mund t'ia lëmë fajin modestisë, ngathtësisë, humbjes së rastit të mirë që kishte, por, fatkeqësisht, fakti që gjatë gjithë jetës së saj, Emily Dick-

inson gëzoi vetëm një grusht poezi të botuara në shtyp (më pak se njëzet), të lë në shpirt një shije të hidhur.

Eshtë e vërtetë se ajo e kalonte kohën, më së shumti, e mbyllur në shtëpinë e babait të saj, në Amherst të Massachusetts. Megjithatë, jeta shpëtoi nuk e bëri poeten e madhe të tërhiqej nga bota. Ajo u shkruante letra të gjithë atyre që njihje, shkante në shumicën e aktiviteteve kulturore të qytetit dhe, ngaqë i ati ishte avokat, ajo pati mundësinë ekonomike të përfundonte studimet në Akademinë e Amherst-it. Aty ajo u njoh me gjerësisht me krijimtarinë letrare të Shakespiare-s, Byron-it, Goethe-s, Tennyson-it, etj. Faktikisht, në vend që të mërzhitej, Emily e çmonte pa masë ngrohtësinë, frymëzimin dhe sigurinë që i afronte familja dhe shtëpia. "Nuk ka gjë më madhështore se fuqinë infinite të shtëpisë" — thoshte ajo.

Pavarësisht nga optimizmi që kishte për mënyrën e jetesës, mungesa e gjatë e emrit të saj në shtyp nuk jepte shpjegime të mjaftueshme për familjen dhe shoqërinë e saj. Ato e dinin se ajo i kishte kushtuar një jetë të tërë leximit dhe krijimit të poezisë dhe me të drejtë prisnin rezultatet e punës së saj. Gjithsesi, ajo ishte plotësisht e ndërgjegjshme se ishte poete, jetonte si poete dhe e dinte se këndvështrimi të saj unik për poezinë do i vinte dita.

Natyrisht, ajo kishte pasë të drejtë. Ndonëse në një atmosferë të zymtë familjare dhe shoqërore, enigma u zgjidh më në fund. Menjëherë pas vdekjes së Emily Dickinson-it, e motra zbuloi

1,775 poezi, të cilat përbënin të rrahurat e vërteta të zemrës të poetes së madhe. Një numër kaq i madh poezish me të drejtë u bë objekt i bisedave të përditshme të intelektualëve dhe poetëve më të mëdhenj botërorë të asaj epoqe të zjarrtë poetike. Befasia që solli Emily Dickinson u kthye menjëherë në këtë mesazh fisnik: të jetosh me ëndërrën se gjithçka është e mundur nëpërmes disiplinës, punës këmbëngulëse dhe ideve të mëdha poetike është një vërshim real drejt idealit të shenjtë të çdo artisti.

Një numër i madh poezish u gjetën të shkruara në copa letrash. Bile, disa prej tyre ishin shënuar "me ngut" në dy anët e pareve, nga që s'i kishte ndodhur leter me vete në kohën e frymëzimit. Kjo nuk ishte asgjë e re për familjen dhe miqtë e saj, sepse ata e dinin se Emily Dickinson e kishte pjesë të praktikës së saj të shkruarit kudo, kurdo e në çfarëdo vendi, kur i vinte një ide... Vetëm pasi kthehej në mbrëmje në shtëpi, i hynte dhe i rihynte punës për organizimin e mendimeve të saj në formë poetike.

Nuk ka gjë më të vështirë se të pranosh faktin se segmenti jetësor i një poeti, nganjëherë, mbaron aty ku fillon vepra e tij. Vetëm në vitin 1890, katër vjet pas vdekjes, u botua përmbledhja e parë me poezitë e Emily Dickinson-it. Aroma e këndshme poetike e vargjeve të saj u shpërnda në ajrin e pafundësisë të së ardhmes si një parfum magjik, era e mirë e të cilit do të kënaqte lexuesit për një kohë të pafund.

Në poezinë e Dickinsonit gjejmë një tejdukshmëri të rrallë. Ndonëse, nganjëherë poezia e saj na paraqitet disi aventuriere nga plastika, ajo ka vlera të mëdha në aspektin e sinjërimit poetik. Ç'është me e rëndësishmja, poezia e Emily Dickinsonit është psikologjikisht krejtësisht e depërtueshme për lexuesin e kualifikuar. Aq më tepër në poezinë e saj gjejmë të bashkangjitura artin, inteligjencën dhe dhimbjen njerëzore, të cilat janë aq të rëndësishme në poezi. Pra, ajo ka gjetur forma që të vërë poezinë e saj në shërbim të të gjithë lexuesve dhe krijuesve njëherësh.

Në aspektin personal, biografët e saj e përshkruajnë poetin si një njeri plot jetë, që e donte pamasë njeriun dhe natyrën. Emily Dickinson ishte e shqetësuar për kohën dhe jetonte me uljengritjet e fatit të bashkëkohësve të saj. Po kështu, ata sugjerojnë se poetesha nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie dashurie. Miqësitë që ka pasur me burrat gjatë jetës së saj kanë qënë prër të karakterit intelektual. Megjithëse vepra e saj na bind se dashuria e saj e vërtetë ishte poezia, tek lexon vargjet e saj për dashurinë logjika të shtyn të mendosh se ajo e ndjente mungesën e djemve në rininë e saj. Ja disa vargje nga poezia e saj (903, ca. 1846):

Më ke të fshehur në lulen time, Që po të velet nëpër duar — Ti, papritur, ndjen për mua, Pothuajse vetminë e trishtuar...

Të punësosh një redaktor për poezinë që nuk e njeh atë është e padrejtësia më e madhe që mund t'u bëhet poetëve dhe poezisë që ata krijojnë.

në vëllimin e dytë është shkruar në kushtet e mungesës së plotë të saj. Nëse në vitin 1998 ende poeti nuk po e kuptonte se ku do të shkojë kjo anije në të cilën është vetë në të, me botimet e fundit frymëmarrja e tij poetike është e lirë, por gjithnjë e shqetësuar, për të vetmet arsye se shpirti i poetit kurrë nuk është i qetë.

Poeti Bajazit Cahani, në krijimtarinë artistike të tij, nuk ka bërë shumë zhurmë, sepse shpesh herë ndodh që pulat kakarisin e bërtasin aq shumë, sikur nuk kanë bërë një vezë, por një asteroid. Tjetër gjë vlen për të. E rëndësishme është se poezia e tij flet vetë. Poezia fund e krye ka intensitet, ka ritëm, ka dritë... Zhurma e krijimit të tij vjen si një uragan i brendshëm drejt e të njerëzit, se posaqërisht për të është shkruar.

...Frytë erërat e forta të jetës

Dhe çelën kanatet e zemrës sime...”, shkruan poeti që në vitin 1972, pikërisht në atë vit kur liria ndihej, por ishte e ndrydhur nga hija e zymtë e shpatës së famshme e “krasitjes së filizave” të asaj kohe.

Poezia si mision

Poezitë e Cahanit, padyshim zënë vend në antologjinë poetike shqiptare. Kjo është një arritje e madhe artistike e poetit, kredo e tij. Bajazit Cahani me veprën e vet, sikur u thotë njerëzve, se fundi i madh i botës, janë veprat e përfunduara e jo idetë për t'i krijuar ato.

...Vetveten shoh me të\Dhe botën pa fund në shoh,\Të vjetrën me gjëmime duke rënë dhe të renë duke u ngjitur kudo...

Kështu shprehet me ndërgjegje poeti duke e vënë veten në rolin e një misionari që ka një detyrë për të realizuar.

Autori ka parë përmes syve të krijimit artistik, aq sa duhet dhe jo aq sa munden. Kështu ai është shumë racional në pikëpamje artistike. Prandaj ai, bashkë me brezin e vet, bëhen të domosdoshëm në krijimin e poetëve të mëvonshëm, por edhe të domosdoshëm edhe për jetën tonë të përditshme sociale, artistike dhe intelektuale. Krijimtaria e tij, na jep atë që na duhet. Dhe na sjell atë që na nevojitet e na shërben. Kjo krijimtari poetike, prek ato çështje që për ne janë plagë që dhëmbin e dhëmbin. Në fakt, ky është misioni i poetit dhe artistit në përgjithësi, por në fakt dhe qëllimi i tij. Kur ende nuk kishte mbushur 19 vjet thotë poetikisht te poezia “Dua të hap një autostradë”

...Po unë nuk eci dot më poshtë e lart
Nëpër këtë rrugë (monotone tashmë) nga të tjerë
çelur.\Dua të hap një autostradë,\Pa çka se vetë,
ndoshta,\Mes autostradës sime\Kam për të nge-
lur...

Në këtë kontekst, poeti Bajazit Cahani është si ai lisi i madh me kurorë të madhe, nën hijen e të cilit pushojnë shumë njerëz. Autori përmes vargut të tij artistik jo vetëm që ka përcjellë mesazhin, por ka arritur edhe qëllimin e vet, misionin se pse e ka shkruar.

Moderniteti i vargut poetik

Poezia e Bajazit Cahanit është moderne, por ajo kurrësesi nuk mund të ndërtohet jashtë lëndës tradicionale dhe autoktone ku ka jetuar dhe ka prekur gjithçka me dorën e vet malit, gurit, fushës, lisit, sharkisë, vashës së tij. Kjo është lënda për të krijuar modernitetin poetik. Këtu qëndron edhe magjia e poezisë së tij. Kur ai mbështet kokën në çatinë shkëmbore të maleve të veta “...askush të mos guxojë t'i mbyllë buzë e çerpikë, shëjëzë, ai është në këngëtim”. Gjithë ky



kompleksitet poetik i krijuesit, gjithë kjo lëndë që ai mbledh për ndërtesën e tij poetike, e shtyn që trevën ku ka lindur, ta cilësojë “Has, Homeri im”. Nuk kam mundur të gjej fjalë për ta shtjelluar më shumë rëndësinë që ai i kushton djepit ku ka lindur, djep i cili ka fatin të ketë traditën më të hershme poetike në botën krijuese shqiptare. Në letërsinë tonë të vjetër, nuk është folur asnjëherë për një traditë poetike, përveç traditës poetike të Hasit përfaqësuar prej Pjetër Bogdanit dhe gjithë plejadës së poetëve të asaj kohe deri te Gjon Nikollë Kazazi.

Legjenda është e preferuara e poetit si lëndë për krijimin e tij. *Likeni i Kuq, Djepi, O, Azem Bejtja, Kënga e majekrahut, Kënga e Topit të Pistës,* janë dëshmi të asaj që ne shprehëm më lart, nevojës së domosdoshme të poetit për ta thirrur këngën, për ta zgjuar atë prej aty ku është dhe për t'i dhënë frymë, jetë, art e përjetësi.

Në fund të fundit, ky është edhe qëllimi kryesor i poetit. Nëse artistët, poetët e krijuesit në përgjithësi, nuk janë të lumtur, kjo vjen nga ajo se lumturia atyre nuk u intereson shumë. Poetët, lumturinë më shumë e duan të jetë prezente në sytë e njerëzve, në sytë e fëmijës dhe të së dashurës, inipse sytë e tij nuk e kanë shkëlqimin e duhur e rrezatojnë herë pas here pessimizmin. Poeti gjithnjë është altruist, si i thonë vulgarisht janë më shumë lopatë se sa shatë.

Vijon nga faqja 6

Është tamam si të punësosh një veterinar për të kryer punën e një doktori. Këtë do e pohonte pa hezitim T.W. Higginson. Ai qe redaktori i parë i poezisë së Emily Dickinson-it, tek punonte si radaktor i faqeve letrare pranë gazetës *Atlantik Monthly*. Fakti që ai ka mbetur në histori si njëri nga kritikët letrar me disiluzionues të shekullit IXX nuk e ngjall dot atë që u shua me vdekjen e poetes.

Ndonëse ai e pat pranuar akuzën dhe u pat kërkuar falje lexuesve të *Atlantikut* për mosarritjen e njohjes në detaje të gjeneralitetit poetik të Dickinson-it, moskompetenca e tij nuk mund të falet lehtë. Emily Dickinson i kishte dërguar disa herë poezi, por gjatë gjithë karrierës së tij, T. W.

Higginson-i s'i kishte thënë një fjalë inkurajuese. Poetja, duke i besuar gjykimit të tij, hezitoi të dërgonte poezitë e saj tek gazetata e revistat e tjera. Megjithatë, si për ta ngjitur atë që kishte thyer, Higginson u tregua mjaft aktiv në botimin e veprës mbas vdekjes së poetes..

Cilat ishin pakënaqësitë e tij ndaj poezisë së poetës së madhe? Ai ia kishte kthyer e rikthyer mbrapa poezitë me mendimin se ato ishin spazmatike dhe kishin mangësi në rimë dhe sintaksë. Ai shprehte shqetësimin edhe për një numër të madh vizash lidhëse, shumë pauza, për disa variante radikale të ritmit poetik etj. Ndoshta z. Higginson, drejtonte kritikën e tij në këto drejtime për të fshehur arsyen e vërtetë; pra për të mos thënë që ajo ishte femër dhe se kishte

Pikërisht, kjo veti e poetëve dhe artistëve në përgjithësi, bën që artistët në përgjithësi të jenë të veçantë. Nëse studiuesit e hulumtojnë gjithnjë, artistët gjejnë gjithnjë atë që studiuesit hulumtojnë e kërkojnë. Pra studiuesit janë në kërkim, ndërsa poetët në gjetje të asaj që kërkojnë ata.

Kini parasysh vetëm poezinë “Hoj, dada, hoj” të poetit Bajazit Cahani. Studiuesit e kanë kërkuar këtë këngë, por asnjëherë nuk e kanë bërë ata prezente, të paraqitshme, asnjëherë nuk kanë mundur të shpalosin vlerat e saj, madje

e gjërë dhe të larmishme, del në dukje menjëherë vargu i gjatë i mbushur me lëndë dhe i ngjeshur me fjalën e zgjedhur. Herë herë të duket sikur lexon prozë poetike, por që nuk ka asnjë pikë narracioni.

Përdorimi i një vargu të tillë shpërthyes, nëntekstor, që vijon me reticencë që nënkupton vijimin e mendimit, është drejtpërdrejt tendencë për të thyer tabutë e vendosura në artin poetik të asaj kohe, por edhe të rregullave të krijimit artistik që praktikohen sot. Kjo papajftueshmëri në teknikën poetike që deomos shoqërohet me “idetë e paqarta” apo “të errëta” të Bajazit Cahanit e ka bërë kastën vlerësuese që ai të mbetet deri diku në hije. Them deri diku se askush në asnjë formë nuk ka mundur t'i ndalë thirrjen e tij artistike. Hapësira e vargut nënkupton tendencën e përhershme të poetit në kërkim të së resë, bashkëkohores, modernes në artin e vet, por në të njëjtën kohë në gjetjen e mënyrave e formave të shpalosjes së ideve e mendimit të përparuar avanguardist. Ja si e shtrin vargun poeti te poema “Nada” për t'i dhënë jetë idesë që do t'i japë jetë:

...ti do të vish në këtë mbrëmje që digjet...
përmes turmës së njerëzve do të vish,
duke kaluar si një gjuhë flake nëpër muzg...
nën reflekse reklamash,
që shuhen e ndizen,
duke firmosur papushuar në letrën e madhe e të
zezë të natës DASHURINË TONË!

Sipas koncepteve artistike të autorit vetëm kështu mund të përmbushej misioni që kishte poezia e tij në raport me shoqërinë. Ai nuk shkruan poezi për vete, por për vete dhe të tjerët, ndërkohe që idetë poetike i vijnë vetë si dhuratë e kërkimeve të përhershme brenda realitetit ku ai bën pjesë, se ai është i vetëdijshëm se pa liri të mendimit nuk mund të ketë krijim të vërtetë artistik. “Pa liri, letërsia, ajo e vërteta, nuk ekziston”, -u shpreh Ismail Kadareja në një intervistë të kohëve të fundit.

Me krijimtarinë e dëshmuar artistike, Bajazit Cahani, prish disa sisteme që e kanë bërë poezinë të vuaj dhe të jetë skematike, e varfër për nga gjetja e përdorimi i fjalës por edhe narrative. Këto dukuri që i ulin vlerat artistike krijimit, janë të padurueshme për të. Forca e vargut të tij shndërrohet deri në lëndë shkatërruese që shkërmoq gjithçka që bie era myk dhe ndërton diçka tjetër të ndryshme, të kundërt që kundërmon freski dhe aromë këndellëse. Poezia e Cahanit nuk është patetike, por e thirrjeve të të brendshme. Në poezi poeti Bajazit Cahani, është gjenerues i guximshmëm i ideve të reja artistike e përqes i drejtpërdrejtë i mesazhit tek njerëzit.

Pikërisht për këtë Bajazit Cahani, futet në kategorinë e atyre krijuesve që nuk martohet me poezinë, por e mban atë dashnore të përjetshme, se ai e di shumë mirë se bota nuk është e atyre që ngrohen, por atyre që kallen në të, siç do të thoshte intelektual i viteve tridhjetë Ismet Toto. Bajazit Cahani ka qenë, është e ka mbetur flaka në udhëtim... që udhëton përherë...nëpër kohë.

përgjithësi, bën që artistët në përgjithësi të jenë të veçantë. Nëse studiuesit e hulumtojnë gjithnjë, artistët gjejnë gjithnjë atë që studiuesit hulumtojnë e kërkojnë. Pra studiuesit janë në kërkim, ndërsa poetët në gjetje të asaj që kërkojnë ata.

Kini parasysh vetëm poezinë “Hoj, dada, hoj” të poetit Bajazit Cahani. Studiuesit e kanë kërkuar këtë këngë, por asnjëherë nuk e kanë bërë ata prezente, të paraqitshme, asnjëherë nuk kanë mundur të shpalosin vlerat e saj, madje

Sipas koncepteve artistike të autorit vetëm kështu mund të përmbushej misioni që kishte poezia e tij në raport me shoqërinë. Ai nuk shkruan poezi për vete, por për vete dhe të tjerët, ndërkohe që idetë poetike i vijnë vetë si dhuratë e kërkimeve të përhershme brenda realitetit ku ai bën pjesë, se ai është i vetëdijshëm se pa liri të mendimit nuk mund të ketë krijim të vërtetë artistik. “Pa liri, letërsia, ajo e vërteta, nuk ekziston”, -u shpreh Ismail Kadareja në një intervistë të kohëve të fundit.

shme për botim, dhe kështu ajo vendosi t'i mban-te krijimet e saj vetëm për vete.

Në përfundim, Emily Dickinson është një nga ata poetë që sa herë që i lexoj, më bëjnë ta dua edhe më thellësisht poezinë. Poetë si ajo, më kanë bërë që të arrij në përfundimin se poezia është shpirti i letërsisë — gjinitë e tjera letrare edhe mund të funksionojnë disi në forcat e veta, por të pambarsura me komponentin poetik ato tingëllojnë si një trokitje te dyert e vdekjes. Ndoshta edhe unë personalisht do të jetoja disi edhe pa poetët; por pa ta, diçka e papërshtueshme do të mungonte midis meje dhe Zotit.